



A.nr.1796/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi- Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1796/2025, të datës 14.10.2025, të parashtruar nga ankuesja SH.R, nga Prishtina, kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 10.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1796/2025, e datës 14.10.2025, e parashtruar nga ankuesja SH.R.

II. Anulohet Vendimi me Nr.Ref.01680/2025 i datë 15.09.2025, i Komisionit Disiplinor në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës.

III. Obligohet Udhëheqësja e Divizionit për Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civil SH.R (*tutje referuar* ankuesja), më datë 14.10.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1796/2025 kundër Vendimit me Nr.Ref.01680/2025, të datës 15.09.2025, të Komisionit Disiplinor në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, përmes të cilit akt të njëjtës i është shqiptuar masa e rëndë disiplinore “*ndalim i njëzet për qind (20 %) të pagës bazë për periudhën prej 1 muaj*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar* Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave, me datë 20.10.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare për Krahassim dhe

Verifikim të Pronës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 12.11.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Tutje, Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me Vendim me numër protokolli 7580/2025, të datës 26.11.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1796/2025, të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (tutje referuar Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6786/2025, të datës 14.10.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Dokument identifikimi i ankueses; Vendimin me Nr.Ref.01680/25 të datës 15.09.2025; E-mailat e datës 13.06.2025; Deklaratat nga: Sh.F, B.N, G.M, L.A-K si dhe V.K; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 20.10.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 12.11.2025; Akt emërimit me Nr.145/2025 të datës 16.07.2025, me përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin me Ref.nr.01346/25 të datës 01.07.2025; Akt emërimit me Nr.00009/2025 të datës 06.01.2025; E-mailin e datës 14.06.2025; E-mailin e datës 23.06.2025; Vendimin me Nr.Ref.0156/24/sa të datës 22.07.2024; Vendimin me Nr.Ref.00279/25 të datës 27.01.2025; Vendimin me Nr.Ref.00177/25 të datës 10.01.2025; Vendimin me Nr.Ref.00173/25 të datës 10.01.2025; Diplomat e anëtarëve të Komisionit Disiplinor; E-mailin e datës 15.09.2025; Raportin e vijueshmërisë së punës të ankueses; Listat e pagave; Formularët e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 15.01.2023, 25.01.2024 dhe 28.02.2024; Vendimin me Nr.Ref.01284/25 të datës 26.06.2025; Vendimin me Nr.Ref.01453/2025 të datës 30.07.2025; Procesverbalin e datës 24.06.2025 të A.B-A; Procesverbalin e datës 23.06.2025 të A.L; Procesverbalin e datës 23.06.2025 të Sh.R; Procesverbalin e datës 19.06.2025 të L.A; Procesverbalin e datës 19.06.2025 të G.M; Procesverbalin e datës 19.06.2025 të Sh.F; Procesverbalin e datës 19.06.2025 të L.A; Procesverbalin e datës 19.06.2025 të B.N; E-mailin e datës 24.06.2025, për mbajtjen e seancës disiplinore; E-mailat e datës 19.06.2025, lidhur me mbajtjen e seancave disiplinore; E-mailat e datës 26.09.2025, lidhur komentet mbi procesverbalet e seancave disiplinore; E-mailin e datës 13.06.2025; E-mailin e datës 17.06.2025, me korrespondim prej 5 faqeve; E-mailin e datës 26.06.2025; E-mailin e datës 22.06.2025, nga V.K, me korrespondim prej 3 faqeve; Vendimin me Nr.Ref.01675/25 të datës 15.09.2025; Kontratën me Nr.02/2025 të datës 28.03.2025, me formularin e përshkrimit të punës; Vendimin me Nr.Ref.01678/2025 të datës 15.09.2025; Akt emërimit me Nr.00061/2025 të datës 06.01.2025, me formularin e përshkrimit të punës; Vendimin me Nr.Ref.01679/25 të datës 15.09.2025; Akt emërimit Nr.00115/2025 të datës 06.01.2025, me formularin e përshkrimit të punës; Vendimin me Nr.Ref.01677/25 të datës 15.09.2025; Akt emërimit me Nr.00056/2025 të datës 06.01.2025, me formularin e përshkrimit të punës; Vendimin me Nr.Ref.01676/25 të datës 15.09.2025; Vendimin me Ref.nr.00935/25 të datës 08.05.2025; Akt emërimit me Nr.148/2025 të datës 17.07.2025, me formularin e përshkrimit të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesja sipas Akt Emërimit me Nr.145/2025 të datës 16.07.2025, është e punësuar në pozitën **Udhëheqëse e Zyrës Regjionale në Prishtinë**, në Departamentin për Koordinim Regjional në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (në tekstin e mëtejme referuar: Agjencia).

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Departamentit për Koordinim Regjional në organin përkatës të punësimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të përgjegjësiave ligjore që burojnë nga roli i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, me datë 14.06.2025, ka paraqitur analizën dhe rekomandimet, që lidhen me ngjarjen e ndodhur me datë 09.06.2025, gjegjësisht ka parashtruar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses si dhe pesë (5) zyrtareve tjera të këtij organi punësimi. Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Departamentit për Koordinim Regjional, sipas kësaj shkrese rezulton se, procedurën disiplinore ndaj ankueses e ka iniciuar, me pretendimin që roli i saj të vlerësohet nga Komisioni Disiplinor në kuadër të ushtrimit të përgjegjësiave si mbikëqyrëse, me theks të veçantë në mos komunikimin në kohë të informacionit nga ana e stafit, duke shtuar se kjo situatë mund të sinjalizojë mangësi në ndërtimin e një komunikimi funksional dhe ta qartë, si dhe nevojën për përmirësim të raportimit brenda njësisë organizative

Ndërsa, Komisioni Disiplinor i Agjencisë, përmes Vendimit me Nr.Ref.01680/25, të datës 15.09.2025, ka shpall ankuesen përgjegjëse për shkelje të rëndë disiplinore, gjegjësisht për moslajmërim të shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës, të përcaktuar me nenin 56 paragrafin 4 nën paragrafin 4.2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, e në mbështetje të nenit 57, paragrafi 2.1 të këtij ligji, i ka shqiptuar masën disiplinore *“ndalim i njëzet për qind (20 %) të pagës bazë për periudhën prej 1 muaj”*.

Ankuesja, kundër Vendimit me Nr.Ref.01680/25, të datës 15.09.2025, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë, ka parashtruar ankesë në Këshill, për shkak të shkelje së dispozitave të procedurës disiplinore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, andaj kërkon shfuqizimin aktit të kontestuar me ankesë.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në autorizimet e përcaktuara me nenin 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shqyrtuar në kuptim të ligjshmërisë aktin e kontestuar në ndërlidhje me provat e bashkangjitura të lëndës, si rrjedhojë ka konstatuar se iniciimi i procedurës disiplinore ndaj ankueses, i filluar sipas shkresës së datës 14.06.2025, nga Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Departamentit për Koordinim Regjional, nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të përgjegjësiave ligjore që burojnë nga roli i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, përkatësisht me nenin 59, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *“2. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësiave të punës nga nëpunësja/i civil”*, ngase bazuar në provat shtesë të kërkuara më datë 23.12.2025 dhe të ofruar më datë 24.12.2025 nga organi përkatës i punësimit, rezulton se iniciuesi i procedurës disiplinore përmes Vendimit me Ref.Nr.01356/25 të datës 10.07.2025, është caktuar në pozitën e kategorisë së mesme drejtuese, atë të **Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Departamentit për Koordinim Regjional**, nga pozita e punës e **kategorisë Profesional 1, Zyrtar i Lartë për Koordinim Regjional** në Zyrën Regjionale në Gjilan-Departamenti për Koordinim Regjional të Agjencisë, të cilën e mbanë sipas Akt emërimit me Nr.00009/2025 të datës 06.01.2025.

Andaj, Kolegji i Këshillit, bazuar në konstatimin si më sipër, duke i u referuar dispozitave të aplikueshme ligjore që rregullojnë caktimin e ushtruesve të detyrës të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i publikuar me datë 02.06.2025 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me datë 17.06.2025, përkatësisht nenit 9, ku përcaktohet se: *1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët*

dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari. 2. Paragrafi 3. i nenit 35 të Ligjit bazik riformulohet si vijon: 3. “Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se dymbëdhjetë(12) muaj përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur por për arsye objektive pozita nuk është plotësuar”. 3. Paragrafi 4 i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej dy (2) viteve.; dhe paragrafit 2 të nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në varësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se organi i punësimit me rastin e caktimit të nëpunësit përkatës në pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Departamentit për Koordinim Regjional, ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita të aplikueshme ligjore të përcaktuara më lartë dhe që ndërlidhen me këtë çështje, ngase në rastin konkret është dashur të caktoj një zyrtar të lartë nga kategoria pasuese, apo thënë më konkretisht një zyrtarë që mbanë pozitën e kategorisë së ulët drejtuese me akt të konfirmuar, respektivisht Udhëheqës i Divizionit në kuadër të Departamentit përkatës, sikurse në rastin e ankueses, ndërsa në rastin konkret mbi dëshmitë e paraqitura dhe konstatimin e pasqyruar si më sipër rezulton se z. A.L, ka kaluar nga niveli profesional 1 në atë të kategorisë së mesme drejtuese.

Andaj, referuar konstatimit si më sipër se caktimi i iniciuesit të procedurës disiplinore është realizuar mbi shkelje të dispozitave përkatëse ligjore, gjegjësisht duke anashkaluar nëpunësit të cilët mbajnë pozitat e nivelit të ulët drejtuese brenda Departamentit përkatës të Agjencisë, Kolegji i Këshillit, me qëllim të vërtetimit të ligjshmërisë së aktit të kontestuar me ankesën e datës 14.10.2025, mori për bazë dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht: nenin 4, paragrafin 1 dhe 2 ku përcaktohet se: “1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj; si dhe nenin 52, ku përcaktohet se: 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit; dhe për rrjedhojë konstaton se Vendimi me Nr.Ref.01680/25, i datës 15.09.2025, mbi të cilin Komisioni Disiplinor i Agjencisë e ka shpallur ankuesen përgjegjëse për shkeljen e rëndë disiplinore, konkretisht për moslajmërim të shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës, duke i shqiptuar më tej masën disiplinore “ndalim i njëzet për qind (20 %) të pagës bazë për periudhën prej 1 muaj”, është i pa ligjshëm në kuptim të nenit 4 dhe nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për faktin se iniciuesi i kësaj procedure disiplinore, mbi bazën e asaj që u konstatua si më lartë, përkatësisht vendimit që është objekt i kësaj ankese është nxjerrë në mënyrë të kundërligjshme mbi arsyet e specifikuara më lartë, e që ndërlidhet drejtpërdrejtë me mungesën e

kompetencës dhe autorizimeve ligjore për inicim të procedurës disiplinore, si rezultat arsyeve të specifikuar më lartë në arsyetim të këtij vendimi, pasi që i njëjti zyrtar rezulton se është caktuar në mënyrë të kundërligjshme në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Departamentit për Koordinim Regjional në kuadër të Agjencisë.

Kolegji i Këshillit, marrë parasysh konstatimet si me sipër, nuk është lëshuar edhe në qështje tjera që ndërlidhen me këtë objekt të kësaj ankese, për faktin se nuk mund të ndryshoj përmbajtjen si në dispozitiv të këtij vendimi, ngase shkeljet ligjore janë evidentuar qysh në fillim të kësaj procedure disiplinore, kështu që Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmerisë vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën A.nr.1796/2025, të datës 14.10.2025, dhe të anuloj Vendimin me Nr.Ref.01680/2025 të datës 15.09.2025, të Komisionit Disiplinor në Agjencinë Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, me obligimin ligjor që Udhëheqësja e Divizionit për Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, masën disiplinore të anuluar si në pikën II të dispozitivit, ta largoj nga dosja personale e nëpunëses civile përkatësisht ankueses.

Andaj, theksuar si më sipër e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1796/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses SH.R;
- Udhëheqëses të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.